REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor [1]	Data e kërkesës[2]	Objekti i kërkesës[3]	Data e përgjigjes [4]	Përgjigje[5]	Mënyra e përfundimit të kërkesës[6]	Tarifa [7]
1.	11.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me çmimin e produkteve ushqimore.	11.02.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës ka hapur në fund të vitit 2025 një procedurë monitorimi për produktet e shportës, duke u fokusuar tek supermarketet. Autoriteti i Konkurrencës është në proces analizimi të trendit të çmimeve, për të vlerësuar dinamikën e tregut dhe për të identifikuar nëse ka elementë, që mund të rezultojnë në sjellje të mundshme në kundërshtim me rregullat e konkurrencës. Çdo vlerësim konkret do të bëhet në përfundim të analizës së plotë dhe në përputhje me procedurat ligjore, në këndvështrim të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.	E plotë	Nuk ka
2.	20.02.2026	Kërkesë për infromacion në lidhje me proceset e emërimit/zgjedhjes së zyrtarëve të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues, CV-të dhe masat	27.02.2026	Kthim përgjigje duke bërë me dije se për periudhën 01.09.2025 deri tani, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka pasur vende të lira pune në pozicione të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues të shërbimit civil. Procedurat e ndjekura në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil, për vendet vakante të shpallura, gjenden të publikuara në faqen zyrare, sipas linkut	E plotë	Nuk ka

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		administrative në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".		https://caa.gov.al/publications-category/vende-vakante2/ . Për sa i përket masave administrative në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", gjatë periudhës 01.09.2025 deri tani, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka marrë masa administrative në zbatim të ligjit nr. 138/2015, ndaj zyrtarëve të zgjedhur, të emëruar apo stafit drejtues. Në lidhje me transparencën e të emëruarve/zgjedhurve ju bëjme me dije se në faqen zyrtare të institucionit gjenden të publikuara përmbledhje të jetëshkrimit të anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës, si dhe drejtorëve të drejtorive, sipas linkut https://caa.gov.al/autoriteti-i-konkurrences/organizimi/ .		
3.	18.03.2026	Kërkesë për informacion mbi mënyrat zyrtare të ankesës mbi çmimet e fryra dhe të pajustifikuara të biletave të transportit publik ndërqytetas Tiranë-Bulqizë dhe anasjelltas.	19.03.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se në lidhje me ankesat mund të plotësoni formularin, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, linku bashkëlidhur https://caa.gov.al/laws/formular-i-ankeses/ , ose mund të paraqiteni pranë ambienteve të institucionit tonë, në adresën rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV, Tiranë, 1004, orari e hënë – e enjte 08:00 – 16:30 dhe e premte 08:00 – 14:00.	E plotë	Nuk ka
4.	08.04.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me dy operatorët e shërbimeve celulare, mbi përfshirjen në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit,	10.04.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1226, datë 18.11.2025, ka vendosur hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Procedura e hetimit është aktualisht në vijim dhe Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës do të vlerësojë edhe aplikimin e normës së IÇK (Indeksit të Çmimeve të	E plotë	Nuk ka

		të drejtën për të indeksuar çmimet me normën e inflacionit për vitin paraardhës.		Konsumit), në kuptim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.		
5.	15.04.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me monitorimin e tregut të karburanteve, si dhe gjetjet në përfundim të këtij monitorimi.	27.04.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të kompetencave të tij, sipas ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka ngritur një grup pune për monitorimin e tregut me shumicë dhe pakicë të karburanteve, proces i cili është në vijim. Në rast se gjatë këtij procesi evidentohen indicie apo shenja të kufizimit të konkurrencës, Sekretariati i porpozon Komisionit të Konkurrencës ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, përfshirë edhe fillimin e procedurave hetimore, në përputhje me parashikimet e ligjit. Nga ana tjetër ju bëjmë me dije se aktualisht funksionon Bordi i Transaparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit, i krijuar me akt normativ, publikuar në Fletoren Zyrtare sipas linkut https://qbz.gov.al/share/O99XnRyLQgeJduEXUKQ5cg .	E plotë	Nuk ka
6.	23.04.2026	Kërkesë për informacion mbi korrigjimin e të dhënave personale, publikuar në Vendimin nr. 996 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në parimin e minimizimit të të dhënave,	28.04.2026	Kthim përgjigje duke bërë me dije se kërkesa juaj do të vlerësohet nga ana e Autoritetit të Konkurrencës dhe në përfundim, do të keni një përgjigje zyrtare.	E plotë	Nuk ka

		sipas ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".				
7.	28.04.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me afatin e përfundimit të procesit të monitorimit në tregun e karburanteve, vënien në dispozicion të gjetjeve të deritanishme, si dhe nisur nga fakti që operatorët në treg ofrojnë çmime identike, duke u rreshtuar në kufirin maksimal të përcaktuar nga Bordi i Transparencës, a do të ketë një procedurë të mirëfilltë hetimore.	29.04.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se raportet dhe analizat e monitorimit të hartuara nga strukturat teknike të Autoritetit përbëjnë dokumente të brendshme pune, të përgatitura në kuadër të ushtrimit të kompetencave hetimore dhe analitike të institucionit. Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, nuk imponon detyrimin për publikmin e dokumenteve të brendshme përgatitore, analizave paraprake apo materialeve që lidhen me procese vlerësimi të papërfunduara, vecanërisht kur publikimi i tyre mund të cënojë efektivitetin e proceseve administrative dhe funksionin mbikëqyrës të institucionit. Proceset e monitorimit dhe analizës zhvillohen në varësi të kompleksitetit të tregut, volumit të informacionit që administrohet dhe nevojës për verifike shtesë. Për rrjedhojë, ato nuk i nënshtrohen afateve fikse të paracaktuara për përfundim. Autoriteti i Konkurrencës ushtron në mënyrë të vazhdueshme kompetencat e veta monitoruese mbi tregje me ndjeshmëri të lartë për konsumatorin, përfshirë dhe tregun e karburanteve, dhe vlerësimi nëse një monitorim do të çojë ose jo në hapjen e një procedure hetimore është kompetencë ekskluzive e tij. Gjithashtu, në rast se keni prova konkrete për bashkëpunim midis operatorëve jo vetëm në këtë treg, por në çdo treg, patjetër që do të vlerësonim shumë bashkëpunimin tuaj.	E plotë	Nuk ka
8.	22.07.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me	30.07.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se në praktikën evropiane, raportet hetimore të autoriteteve të	E kufizuar	Nuk ka

		zbatimin e vendimit nr. 1280, datë 27.03.2026, për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve, konkretisht vënien në dispozicion të raportit të hetimit paraprak, si dhe vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.		konkurrencës, nuk konsiderohen dokumente që u jepen palëve të treta sipas kërkesave për të drejtën e informimit, edhe nëse hiqen të dhënat konfidenciale. Kjo nuk lidhet vetëm me mbrojtjen e sekreteve tregtare, por edhe me mbrojtjen e efektivitetit të hetimit dhe të procesit vendimmarrës të autoritetit. Pas miratimit të vendimit përfundimtar, mund t'ju vendoset në dispozicion versioni jo konfidencial, por jo raporti hetimor. Kjo qasje është në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian dhe me jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, e cila e konsideron dosjen hetimore të konkurrencës si një kategori dokumentesh që gëzon një mbrojtje të veçantë kundër zbulimit për publikun.		
9.	31.07.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me vendimet e Komisionit të Konkurrencës për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj bankave në tregun e sigurimit të jetës për kreditë, si dhe vënien në dispozicion të raportit të hetimit të thelluar, relacionit, analizës juridike dhe procesverbaleve të	13.08.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se lidhur me hetimin e thelluar në tregun e sigurimit të jetës për kredi, vendimet përmbajnë vlerësimin e plotë të Komisionit të Konkurrencës lidhur me bazën ligjore të masave dhe detyrimeve të vendosura; zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar; analizën e fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, si dhe arsyetimin mbi përfundimet e arritura për ndërmarrjet objekt hetimi. Autoriteti i Konkurrencës, kur bëhet fjalë për procedurat hetimore dhe përfundimet e tyre, shprehet zyrtarisht nëpërmjet vendimit të Komisionit të Konkurrencës. Për rrjedhojë, qendrimi institucional dhe arsyetimi juridik e ekonomik i Autoritetit për çështjet e parashtruara në kërkesën për	E kufizuar	Nuk ka

		mbledhjeve ku janë shqyrtuar këto vendime.		informacion, janë ato të pasqyruara në vendimet përkatëse, të cilat përbëjnë aktin zyrtar dhe përfundimtar të procedurës. Vendimet janë të publikuara dhe mund të konsultohen në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, në rubrikën përkatëse. Në lidhje me kërkesën për të sqaruar bazën ligjore dhe metodologjinë e përdorur për trajtimin konfidencial të të dhënave, si dhe për anonimizimin në vendimet e publikuara të vlerave të primeve, komisioneve, përqindjeve dhe të dhënave të tjera, ju bëjmë me dije se trajtimi i informacionit konfidencial të administruar gjatë procedurave të Autoritetit të Konkurrencës, mbështetet ndër të tjera në nenin 30 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar. Në lidhje me vënien në dispozicion të dokumentacionit të procedurës hetimore, ju bëjme me dije se në praktikën evropiane, raportet hetimore të autoriteteve të konkurrencës nuk konsiderohen dokumente që u jepen palëve të treta sipas kërkesave për të drejtën e informimit, edhe nëse hiqen të dhënat konfidenciale. Kjo nuk lidhet vetëm me mbrojtjen e sekreteve tregtare, por edhe me mbrojtjen e efektivitetit të hetimit dhe të procesit vendimmarrës të autoritetit.		
10.	24.09.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me sjelljen e shoqërisë M42 LTD, për mosnjoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar	05.10.2026	Kthim përgjigje, në lidhje me pyetjet e drejtuara duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD në datë 27.11.2024. Pas vlerësimit të dokumentacionit, xhiroja për efekt të nenit 12, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", dhe për llogaritjen e	E plotë	Nuk ka

		nëpërmjet përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD, si dhe vendosjen e gjobës nëpërmjet Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1150, datë 14.01.2025.		masës së gjobës, sipas parashikimit të nenit 73 dhe 15 të ligjit, ka qenë xhiroja sipas pasqyrave financiare të shoqërisë M42 për vitin 2023. Komisioni i Konkurrencës, në pjesën arsyetuese të Vendimit nr. 1150, datë 14.01.2025, ka trajtuar të gjtha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në përcaktimin e gjobës. Ligji 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", në Kreun VI "Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet", i ka dhënë të drejtë Komisionit të Konkurrencës të vendosë gjoba deri në 1%, deri në 10% të xhiros mbi ndërmarrjet apo grupimit të ndërmarrjeve, dhe sanksione individuale deri në 5 milionë lekë mbi individët të cilët me dashje apo nga pakujdesia shkelin ligjin. Mbi këtë bazë ligjore, është në diskrecionin e Komisionit të Konkurrencës të përcaktojë gjobën nga shkelësit e ligjit, e shprehur kjo në përqindje apo në vlerë absolute. Përcaktimi i gjobës ka dy elementë: i) vlera e xhiros së ndërmarrjes/ndërmarrjeve që kanë kryer shkeljen e cila shërben si bazë për të përllogaritur masën e gjobës, dhe ii) përqindja e sanksionit, e cila sipas ligjit dhe për shkeljen konkrete është nga 0-1%. Të dy këta elementë janë të mirëpërcaktuar në ligj dhe në aktet e tjera nënligjore në funksion të ligjit.		
11.	12.10.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me nismën e qeverisë për të fiksuar çmimin e mbi 200 produkteve si rezultat i marrëveshjes së qeverisë me 5	15.10.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës ushtron funksionet dhe kompetencat e tij në përputhje me ligjin nr 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, duke garantuar zbatimin e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Vlerësimi i përputhshmërisë së nismave apo praktikave të caktuara me legjislacionin e konkurrencës kryhet në përputhje me kompetencat apo procedurat e parashikuara nga	E plotë	Nuk ka

		supermarkete në vend, nëse keni qenë pjesë e konsultimit dhe keni dhënë mendim për marrëveshjen, si dhe nese ka rrisqe dhe cënim të konkurrencës.		kuadri ligjor në fuqi, mbi bazën e elementeve konkrete dhe rrethanave përkatëse. Autoriteti i Konkurrencës mbetet i angazhuar në përmbushjen e misionit të tij ligjor, në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në interes të konsumatorëve dhe të zhvillimit të ekonomisë.		
12.	21.10.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me zbatimin e masave të përcaktuara në Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës, në përfundim të hetimit të thelluar ndaj shoqërive One Albania SHA dhe Vodafone Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, mbi përmbushjen e detyrimit për të ofruar brenda afatit 90 ditor, paketa të veçanta me kushte dhe çmime më të favorshme për pensionistët		Kthim përgjigje, duke bërë me dije se në kuadër të zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjeve One Albania SHA dhe Vodafone Albania SHA, të dy ndërmarrjet kanë depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit 90 ditor të përcaktuar në vendim, informacion dhe dokumentacion lidhur me masat e ndërmarra për përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës, përfshirë ofrimin e paketave të veçanta të shërbimeve celulare për kategoritë e pensionistëve dhe studentëve. Aktualisht Autoriteti i Konkurrencës është në proces të shqyrtimit dhe vlerësimit të informacionit të përcjellë, me qëllim që konkluzionet e Autoritetit të Konkurrencës të mbështeten në një shqyrtim të plotë dhe objektiv të informacionit dhe dokumentacionit të administruar.	E plotë	Nuk ka

		dhe studentët e moshës 18-23 vjeç.				
13.	26.10.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me tregun e furnizimit me energji elektrike pas liberalizimit të klientëve 20 kV në vitin 2024, nëse ka pasur Autoriteti i Konkurrencës monitorim, vlerësim apo procedurë tjetër; nëse Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar mënyrën e funksionimit të tregut dhe marrëdhëniet ndërmjet OSHEE, OSSH dhe FTL gjatë procesit të liberalizimit; nëse ka marrë Autoriteti i Konkurrencës ankesa, kërkesa apo sinjalizime nga furnizues të licencuar apo klientë lidhur me procesin e liberalizimit, aksesin në informacion	29.10.2026	Autoriteti i Konkurrencës, gjatë vitit 2022, ka shqyrtuar një ankesë lidhur me problematikat e konkurrencës në kuadër të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, e cila është vlerësuar në funksion të dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor përkatës. Në përfundim të këtij vlerësimi, Komisioni i Konkurrencës ka marrë Vendimin nr. 930, datë 16.12.2022 “Për dhënien e disa rekomandimeve Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi rishikimin e pikës 6, të nenit 85, të ligjit nr. 43, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike’”. Nëpërmjet këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka trajtuar ndikimin e kushteve të ndryshme të furnizimit me energji elektrike në konkurrencën ndërmjet ndërmarrjeve që furnizoheshin në tregun e lirë dhe atyre që furnizoheshin në tregun e rregulluar, duke i rekomanduar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë marrjen e iniciativës ligjore për rishikimin e dispozitës së sipërcituar. Vendimi pasqyron vlerësimin e kryer në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese në vitin 2022. Për periudhën pas liberalizimit të klientëve të lidhur në tensionin 20 kV në vitin 2024, Autoriteti nuk disponon dokumentacion mbi një monitorim apo vlerësim të posaçëm për këtë çështje. Autoriteti i Konkurrencës, në ushtrim të kompetencave të parashikuara në nenet 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vlerëson aktet dhe projektaktet e Entit Rregullator të Energjisë nga pikëpamja e ndikimit të tyre mbi	E plotë	Nuk ka

		ose ndryshimin e furnizuesit gjatë vitit 2024, dhe vënien në dispozicion të tyre.		konkurrencën dhe jep, sipas rastit, rekomandimet përkatëse. Vlerësimet e kryera në këtë kuadër kanë pasur për objekt aktet rregullatore të tregut të energjisë elektrike. Ato nuk kanë trajtuar në mënyrë të posaçme çështjet e ngritura në kërkesën tuaj lidhur me marrëdhëniet ndërmjet OSHEE Group, OSSH dhe FTL. Për objektin dhe periudhën e përcaktuar në kërkesën tuaj, nuk rezultojnë të administruara pranë Autoritetit të Konkurrencës ankesa, kërkesa apo sinjalizime nga furnizues të licencuar ose klientë lidhur me procesin e liberalizimit, aksesin në informacion apo ndryshimin e furnizuesit. Për rrjedhojë, nuk ka raste për të cilat të jepen të dhëna mbi natyrën dhe mënyrën e trajtimit të tyre.		
14.	28.10.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me Paketën Fiskale 2027, e cila propozon uljen e TVSH-së për ushqimet bazë, ku kërkohen studimet ose monitorimet më të fundit të tregut të shitjes me pakicë të ushqimeve (supermarket et dhe dyqanet e vogla), përfshirë pjesët e tregut, përqendrimin	04.11.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se lidhur me studimet dhe monitorimet e tregut të shitjes me pakicë të ushqimeve, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 28, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka filluar procedurën e monitorimit të tregut të mallrave të shportës në rrjetet kyesore të supermarketeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi përfshin mbledhjen dhe analizimin e informacionit për periudhën 1 janar 2025-qershor 2025, me qëllim vlerësimin e zhvillimeve të tregut dhe elementëve përkatës nga këndvështrimi i konkurrencës, i cili vjon. Në përfundim të procesit të monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë rezultatet dhe nevojën për ndjekjen e mëtejshme të çështjes, në përputhje me kompetencat, kriteret dhe procedurat e parashikuara nga ligji	E plotë	Nuk ka

		dhe marzhet, si dhe studimet e tregjeve të bukës, miellit, qumështit, vajit dhe mishit; çdo hetim ose vendim i viteve 2023-2026 lidhur me çmimet e produkteve ushqimore bazë, si dhe nëse Autoriteti i Konkurrencës ka planifikuar ose është konsultuar për monitorimin e kalimit të uljes së TVSH-së te çmimet e konsumatorit nga 1 janari 2027, dhe nëse po, metodologjia dhe kalendari.		nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar. Autoriteti i Konkurrencës mirëpret propozimin e bërë nga ekzekutivi për uljen e normës së TVSH-së për ushqimet bazë nga 20% në 6% në kuadër të Paketës Fiskale 2027. Paketa fiskale pas votimit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nuk monitorohet nga Autoriteti i Konkurrencës, por efektet e saj në treg, patjetër që do të monitorohen pas hyrjes në fuqi, duke parë zbatimin e saj nga subjektet përgjegjëse, në kuadër të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar. Masat përkatëse nuk mund të hartohen përpara miratimit në Kuvend, pasi dokumenti në fjalë është akoma objekt diskutimi. Lidhur me veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë periudhës 2023-2026, vendimet e Komisionit të Konkurrencës që lidhen me tregjet e produkteve ushqimore bazë, të renditura në mënyrë kronologjike, të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, janë si më poshtë: • Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 975, datë 14.04.2023; • Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 961, datë 28.02.2023; • Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 1045, datë 29.12.2023; • Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 1131, datë 07.11.2024; • Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 1255, datë 12.02.2026;		

				• Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 1271, datë 25.02.2026; • Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 1319, datë 17.08.2026.		
15.	03.11.2026	Kërkesë për informacion nëse ka pasur analiza nga Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me efektin e kritereve të DST ku kërkohet detyrimisht pronësi e makinerive të rënda si barrierë hyrëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha; nëse në vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës a krijon ky kriter përqendrim të tregut te kompanitë e mëdha dhe a bie ndesh me parimin e konkurrencës efektive, dhe nëse ka pasur rekomandime drejtuar APP dhe Ministrisë së Financave	12.11.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës ka trajtuar në vazhdimësi problematikën e kritereve kualifikuese në procedurat e prokurimit publik, në funksion të identifikimit dhe eleminimit të barrierave të panevojshme të konkurrencës. Megjithatë ndikimi i kritereve që kërkojnë pronësi të detyrueshme të makinerive të rënda në pjesëmarrjen e NVM-ve duhet të vlerësohet rast pas rasti në funksion të natyrës së kontratës dhe strukturës së tregut përkatës. Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 70, të ligjit nr. 9121/2003, vlerëson se kriteret e kualifikimit në procedurat e prokurimit publik duhet të jenë objektivisht të justifikuara, të nevojshme dhe proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës. Kërkesa për pronësinë e mjeteve, duke përjashtuar forma të tjera të ligjshme të disponueshmërisë, si qiraja apo leasing-u, mund të krijojë barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe të dobësojë konkurrencën, nëse nuk mbështetet në nevoja konkrete të kontratës. Megjithatë, një kriter i tillë nuk përbën automatikisht provë të përqendrimit të tregut apo të ekzistencës së marrëveshjeve të ndaluara, të cilat kërkojnë analizë dhe prova të veçanta. Për rrjedhojë, kriteret duhet të garantojnë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e kontratës, pa kufizuar në mënyrë të pajustifikuar pjesëmarrjen	E plotë	Nuk ka

				dhe konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Vendosja sistematike e kriterit që makineritë dhe pajisjet e nevojshme duhet të jenë vetëm në pronesi të operatorit ekonomik, në rastet kur nuk ekziston një justifikim objektiv dhe proporcional, mund të përbëjë kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe të cënojë parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në përputhje me nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, kërkesat për kapacitet teknik duhet të garantojnë aftësinë reale të operatorit për realizimin e kontratës dhe të jenë proporcionale me objektin e saj. Në këtë drejtim, marrja me qira, leasing-u apo forma të tjera të ligjshme të vënies në dispozicion të makinerive duhet të pranohen, për sa kohë garantohet disponueshmëria dhe përdorimi efektiv i tyre gjatë zbatimit të kontratës. Për rrjedhojë pronësia nuk duhet të konsiderohet si kusht i përgjithshëm dhe automatik për kualifikim, por si një nga format e mundshme të disponimit të kapaciteteve teknike. Me Vendimin nr. 851, datë 03.12.2021, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar APP-së që të udhëzojë autoritetet kontraktore të mos vendosin barriera dhe pengesa në hyrje në tregun e prokurimeve publike, nëpërmjet kritereve të përcaktuara në dokumentet standard të tenderit. Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se është e rëndësishme që kriteret e kapacitetit teknik të orientohen drejt disponueshmërisë efektive të makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës dhe jo të kushtëzohen në mënyrë të		

				përgjithshem nga pronësia e tyre, përveç rasteve kur kjo justifikohet objektivisht nga natyra dhe specifikat e kontratës.		

Nuk ka kërkesa të tjera për informacion të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës.